



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë




Kingdom of the Netherlands

12TH

ANNUAL
REPORT

VLERESIMI BAZË PËR SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS






QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420. Opinione e prezantuar në këtë hulumtim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë opinionet e Ambasadës e Mbretërisë së Holandës dhe Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë..

Mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë përmes programit MATRA




Kingdom of the Netherlands



Autori:


Skender Perteshi

Skënder Perteshi është analist dhe studiues i fushës së terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe riintegritit dhe rehabilitimit në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Skënderi është autor i studimeve të shumta hulumtuese që lidhen me temat e sigurisë, siç janë lufta ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, rezilienca, diaspora dhe ekstremizmi i dhunshëm. Ka punuar si bashkëpunëtor dhe konsulent për çështje të sigurisë në organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore si: Fondacionin Finn Church Aid – Helsinki, Royal United Services Institute (RUSI), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE në Kosovë, GCERF, ATRC, CBM, Kompania këshilluese MOONSHOT në Londër, Resolve Network USA.



CONTENTS

LISTA E SHKURTESAVE	1
STRUKTURA DHE BAZA LIGJORE	2
Baza ligjore e punës së Shërbimit Sprovues	2
KONTEKSTI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË SI DHE PRAKTIKAT E REHABILITIMIT DHE TË RIINTEGRIMIT	4
Qasjet e Kosovës për Rehabilitimin dhe Riintegrimin	5
SFIDAT DHE NEVOJAT NË PROCESIN E REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT (R&R)	9
Mungesa e njohurive bazë të stafit të ShSK-së	9
Numri i limituar i stafit në ShSK	9
Mungesa e Njësisë për Menaxhimin e Ekstremizmit të Dhunshëm	10
Koordinimi ndërmjet institucioneve në çështjet e rehabilitimit	11
Mungesa e buxhetit të veçantë për R&R	11
Përzierja e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve R&R	11
REKOMANDIMET	13
Trajnime të të specializuara për R&R	13
Themelimi i Njësisë për Menaxhimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Rehabilitimin	13
Rritja e numrit të stafit të ShSK-së	13
Alokimi i buxhetit të veçantë për R&R	14
Përmirësimi i koordinimit institucional në R&R	14
Bashkëpunimi me komunitetin	14
Ofrimi i një këshilltari për R&R për nevojat e Shërbimit Sprovues	15



LISTA E SHKURTESAVE

ATRC	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
CDF	Fondi për Zhvillimin e Komuniteteve
EDh	Ekstremismi i Dhunshëm
FIQ	Forumi për Iniciativa Qytetare
GCERF	Fondi Global për Komunitete të Qëndrueshme
ICITAP	Programi i Asistencës Ndërkombëtare për Trajnime dhe Hetime Penale
IOM	Organizata Ndërkombetare për Migrim
ISIS	Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut
IS	Shteti Islamik
LHT	Luftëtarët e Huaj Terroristë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
QRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
R&R	Rehabilitimi dhe Riintegrimi
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
ShSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës



STRUKTURA DHE BAZA LIGJORE

Shërbimi Sprovues i Kosovës (ShSK) është institucion qendror në kornizën institucionale të drejtësisë në Kosovë, me mandat të rëndësishëm. Misioni i ShSK-së është “Ngritja e vetëdijes shoqërore duke bashkëpunuar me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë në vendin tonë”.

Shërbimi Sprovues është organ qendror i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegritit shoqëror të personave të dënuar për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë edhe ato të terrorizmit. Për më shumë, ky institucion ka për mandat mbikëqyrjen dhe ofrimin e ndihmës ndaj personave të dënuar për vepra të ndryshme penale, e që janë të dënuar ose të liruar me kusht me vendim të prerë gjyqësor. Sipas strukturës aktuale, Shërbimi Sprovues ka drejtorinë e përgjithshme, e cila është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të këtij institucioni. Drejtoria e përgjithshme ka për detyrë të mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së ShSK-së, si dhe hartimin e strategjive dhe të politikave të ekzekutimit të sanksioneve penale alternative. Për më tepër, ShSK ka edhe zyrat rajonale të cilat funksionojnë krahas strukturës së gjykatave dhe të prokurorive themelore. Aty ku ka gjykatë dhe prokurori themelore ekziston edhe zyra rajonale e shërbimit sprovues. Zyrat rajonale merren kryesisht me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore alternative. Aktualisht ShSK përbëhet nga tri departamente:

1. Departamenti për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative,
2. Departamenti për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht dhe programe, si dhe
3. Departamenti për administratë

BAZA LIGJORE E PUNËS SË SHËRBIMIT SPROVUES

Shërbimi Sprovues i Kosovës e bazon punën në legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale është ligji bazë që rregullon punën dhe mandatin e ShSK-së për zbatimin e dënimeve alternative. Ky ligj ka për qëllim t'i ekzekutojë sanksionet penale, sanksionet kundërvajtëse dhe masat e trajtimit të detyrueshëm. Sipas këtij ligji, sanksionet penale përfshijnë denimet kryesore, denimet alternative, denimet plotësuese dhe vërejtjen gjyqësore.

Punën e SHSK-së e rregullon edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

Nr. 08/L-002, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2021. ShSK



e bazon punën edhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur Nr. 06/L-006, i cili i rregullon procedurat e trajtimit të ShSK-së për të miturit e dënuar për vepra të ndryshme penale.

Aktualisht, Ministria e Drejtësisë është duke marrë disa hapa konkret që synojnë hartimin e bazës ligjore për rregullimin tutje të pozitës dhe mandatit të ShSK-së. Ministria e Drejtësisë këtë vit ka proceduar në Qeveri projekt ligjin për ShSK-në, i cili synon të forcoj mandatin dhe pozicionin e ShSK-së, dhe ta rregulloj punën e këtij institucioni me ligj të veçantë.



KONTEKSTI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË SI DHE PRAKTIKAT E REHABILITIMIT DHE TË RIINTEGRIMIT

Kosova, sikurse edhe vendet e tjera evropiane, është përballur me fenomenin e luftëtarëve të huaj që kanë marrë pjesë në konfliktet në Siri dhe Irak. Vlerësohet se në zonat e luftës në Siri dhe Irak kanë udhëtuar rreth 403 qytetarë të Kosovës. Në numrin prej 403 qytetarëve, përfshihen burrat si luftëtarë të huaj, gratë dhe fëmijët. Në këtë numër përfshihen edhe 50 persona me origjinë nga Kosova, por të lindur ose rritur në diasporë. Me kolapsimin e të të ashtuquajturit 'Shteti Islamik', Qeveria e Kosovës u tregua e gatshme t'i riadhesonte qytetarët e vet nga vatrat e luftës së Sirisë e Irakut, duke dhënë shembull të mirë se si një shtet me resurse të kufizuara financiare e njerëzore përkujdeset që t'i kthejë qytetarët e saj nga zonat e luftës, dhe t'u japë një mundësi të dytë për jetë.

Deri në maj të vitit 2019, afërsisht 130 kosovarë janë kthyer nga zonat e luftës. Ndaj tyre janë ndërmarrë procedurat hetimore dhe janë dënuar sipas ligjeve në fuqi. Për më tepër, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Qeveria e Kosovës, në maj të vitit 2019 i riadhesoi edhe 110 qytetarë të Kosovës nga kampet e refugjatëve në Siri dhe Irak. Prej të kthyerve, 4 ishin luftëtarë të huaj, e të tjerët gra dhe fëmijë. Po ashtu, në korrik të vitit 2021 Kosova riadhesoi edhe 11 qytetarë të saj nga zonat e konfliktit. Deri më tani në Kosovë janë riadhesuar nga Siria dhe Iraku mbi 250 qytetarë të saj që prej vitit 2011 kur shpërtheu konflikti në këto zona.

Përveç procesit të hetimit dhe dënimit për luftëtarët e kthyer terroristë dhe të atyre të dënuar për terrorizëm, lindi nevoja edhe për zbatimin e programeve për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, si njëra ndër format për deradikalizmin dhe përgatitjen e tyre për t'u riintegruar në komunitet. Zbatimi i programeve të Rehabilitimit dhe Riintegritimit (R&R) kërkonte institucione të specializuara për çështjet e terrorizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për trajtimin dhe mbikëqyrjen e individëve të akuzuar për terrorizëm. Ky proces kërkonte edhe njohuri rreth parandalimit dhe luftimit të traumës dhe të diskriminimit të të akuzuarve për terrorizëm, si dhe përfshirje të komunitetit në programet e rehabilitimit dhe të riintegritimit. Institucionet e vendit nuk e kishin përvojën e duhur për këto sfida.

Për t'u përballur me të kthyerit nga zonat e luftës, Kosova përdori dy qasje të përgjithshme: qasjen ndëshkuese-restorative dhe mbështetjen për riintegrim shoqëror. Qasja ndëshkuese-restorative i referohet kryesisht programeve dhe aktiviteteve të zbatuara nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës (ShSK). Kjo u ofron luftëtarëve të huaj qasje në programe që synojnë t'u ndihmojnë me zhvillimin e shkathtësive, përfundimin e arsimimit, si dhe me trajnime dhe



ligjërata që trajtojnë besimet radikale fetare. Në të njëjtën kohë, qeveria ka krijuar një divizion të posaçëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme për të punuar ekskluzivisht në koordinimin dhe ofrimin e mbështetjes për procesin e riintegritimit të të kthyerve. Ky divizion është përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e të gjitha programeve të rehabilitimit dhe të riintegritimit në Kosovë. Divizioni së bashku me ShKK-në, kanë bartur barrën kryesore për procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit për të dënuarit për vepra penale të terrorizmit.

Për të menaxhuar sa më mirë procesin e R&R si dhe të kthyerit nga luftërat e huaja, MPB, ShKK, Policia e Kosovës, Ministria e Arsimit dhe komunitat kanë ndjekur trajnime të ndryshme me qëllim të zbatimit të programeve dhe të projekteve të rehabilitimit dhe të riintegritimit.

Ndonëse ka një rol të rëndësishëm në procesin e R&R, ShSK ka përfituar shumë pak nga trajnimet e organizatave ndërkombëtare dhe lokale në temat të cilat lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe procesin e R&R. ShSK ka qenë komplet i neglizhuar nga institucionet vendore dhe shumë pak është mbështetur nga donatorët e huaj për projekte të R&R, përkundër faktit se momentalisht trajton numër të lartë të individëve të dënuar për terrorizëm.

Ky raport ofron një vlerësim bazë për identifikimin e sfidave me të cilat përballlet Shërbimi Sprovues në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e të dënuarve për vepra penale të terrorizmit. Për më shumë, raporti ka për qëllim të bëjë identifikimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve profesionale për stafin e shërbimit sprovues, që trajtojnë dhe mbikëqyrin rastet e individëve të dënuar për vepra të terrorizmit.

QASJET E KOSOVËS PËR REHABILITIMIN DHE RIINTEGRIMIN

Kosova ka përdorur dy qasje në procesin e përbaljes më të kthyerit nga luftërat e huaja dhe individë tjerë, të dënuar për vepra të terrorizmit. Qasja e parë ka qenë arrestimi, hetimi, burgosja dhe dënimi i të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në vepra terroriste, që është qasja e fortë. Qasja e dytë, ndëshkuese-restorative, u referohet programeve dhe aktiviteteve qeveritare, të zbatuara kryesisht në kuadër të shërbimit korrektues dhe sprovues, ose sektorit të shoqërisë civile. Kjo qasje synon të mbështesë shkëputjen ideologjike të individëve të burgosur të radikalizuar, si dhe të mbështesë riintegrimin e tyre eventual në shoqëri përmes programeve arsimore që ndërtojnë shkathtësitë e tyre profesionale dhe rrisin shanset për punësim.

Institucionet e Kosovës kanë arrestuar dhe kanë ndjekur penalisht një numër të konsiderueshëm të individëve që janë përfshirë në organizatat terroriste në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak ose kanë synuar ta bëjnë këtë, si dhe ata që i kanë rekrutuar e propaganduar për organizatat terroriste. Shumica e këtyre rasteve kanë përfunduar me dënime. LHT-të e riadhesuar paraqitën një sfidë të madhe për sistemin e drejtësisë në vend, sidomos për procesin e rehabilitimit të tyre. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Sprovues dhe Korrektues i vendit nuk ishte i gatshëm, ose siç thonë ata "nuk ishim plotësisht të përgatitur që t'i trajtonim, dhe nuk e kishim vetëdijen që të



merreshim me ndjeshmërinë e këtij fenomeni”.

Në rastin e Kosovës, ish-anëtarët e ISIS dhe të tjerët, të dënuar për vepra terroriste, janë dënuar me burg efektiv. Paralelisht me vuajtjen e dënimit të tyre, janë përgatitur programe R&R për ta. Me disa përjashtime, shumica e dënimeve që u janë shqiptuar të dënuarve për terrorizëm ka qenë ndërmjet dy dhe katër vjet burg. Koha e shkurtër e dënimeve, hezitimi i të dënuarve për t’u bërë pjesë e programeve të R&R, si dhe ngadalësimi dhe procedurat e gjata në fillimin e zbatimit të programeve për R&R, e kanë bërë pothuajse të pamundshëm implementimin e programeve gjithëpërfshirëse të R&R në sistemin korrektues e sprovues të vendit. Deri më tani, ShSK asnjëherë nuk është përfshirë në procesin e përgatitjes së programeve ose projekteve të R&R, edhe pse një pjesë e madhe e të dënuarve për terrorizëm janë trajtuar dhe ende trajtohen nga SHSK.

Një numër i konsiderueshëm i ish LHT-ve janë liruar me kusht nga ana e gjykatave, si shkak i sjelljeve të mira të tyre ose për faktin se kanë treguar shenja se janë larguar nga veprimet e dhunshme radikale. Të liruarit me kusht, sipas ligjit, kalojnë nën mbikëqyrjen dhe trajtimin e ShSK-së deri në përfundimin e dënimit. Për më shumë, ky institucion ka nën mbikëqyrje rreth 30 gra të dënuara me kusht, të riatdhesuara nga zonat e konfliktit. Shumica prej tyre u dënuan me vendim gjyqësor me dy vite burgim me kusht. Këto vendime janë marrë konform bazës ligjore për zbutje të madhe të dënimit, duke marrë për bazë masat lehtësuese, si pranimi i fajësisë prej tyre dhe sjellja e mirë pas kryerjes së veprave penale.”

Për ShSK-në, lirimet e dënimeve me kusht për të dënuarit për vepra që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm ishin sfidë për shkak të mungesës së përvojës dhe njohurive paraprake të stafit të ShSK-së për trajtimin e rasteve të ngjashme.

Kur flasim për iniciativat R&R, Kosova është shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor që ka krijuar një mekanizëm të veçantë, përkatësisht Divizionin për Parandalim dhe Riintegrimin e personave të radikalizuar (DRPR). Me përpjekjet e saja në R&R, Kosova dha shembullin jo vetëm për njohjen e përgjegjësisë së shtetit kundrejt kthimit të shtetasve të përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, por edhe për përpjekjen për deradikalizimin e të akuzuarve, duke marrë parasysh që ata ato jo gjithmonë paraqesin rrezik për vendin, por kanë mundësinë që një ditë përsëri të jenë pjesëtarë produktivë të shoqërisë.

Në programet R&R është përfshirë një numër shumë i madh i institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, lokale e ndërkombëtare. MPB, nëpërmjet DRPR, ka qenë bashkërenduese e të gjitha këtyre iniciativave. Programi i parë i rehabilitimit në Kosovë është zbatuar nga ana e misionit amerikan të drejtësisë ICITAP, i cili kishte për qëllim t’i zbatonte aktivitetet rehabilituese për të burgosurit e dënuar për terrorizëm nëpër burgjet dhe qendrat rehabilituese të Kosovës. Ky projekt, si i pari në Kosovë, i zbatuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka dhënë një kontribut të madh për ngritjen e kapaciteteve, menaxhimin e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit, vlerësimin e rrezikut për të dënuarit për terrorizëm si dhe për të kuptuarit e progresit dhe për monitorimin e përgjithshëm të sjelljeve të individëve të dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Edhe Bashkimi Evropian me një projekt ka ndihmuar Kosovën dhe Shërbimin Korrektues për ngritjen e kapaciteteve në zbatimin e programeve të R&R për të dënuarit për terrorizëm. Në asnjërinë në këto dy iniciativa nuk ka qenë i përfshirë ShSK. Së fundmi, Këshilli i Evropës ka filluar së zbatuari një projekt për R&R në Kosovë,



ku ka përfshirë stafin e ShSK, për të rritur kapacitetet e stafit për trajtimin e rasteve të terrorizmit.

Ministria e Drejtësisë dhe Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) më 1 maj 2018 kanë arritur një marrëveshje për të mbajtur ligjëratat fetare nëpër burgje, në kuadër të aktiviteteve dhe programeve të R&R të dizajnuara për të denuarit për vepra që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Kjo nismë ka dështuar, për faktin se shumica e të dënuarve për terrorizëm nuk pranuan të ishin pjesë e këtyre ligjëratave, meqë imamët e përzgjedhur "nuk ishin të duhurit", sipas tyre. Këtë marrëveshje e cilëson të dështuar edhe BIK. Sipas tyre, kjo marrëveshje është pezulluar nga Ministria e Drejtësisë, dhe shumë pak është punuar duke u bazuar në të.

Një numër i organizatave lokale kanë përfituar nga Global Community Resilience Fund (GCERF), iniciativë e cila kërkon të forcohet komuniteti ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të mbështeten përpjekjet vendore për R&R për personat e radikalizuar dhe të riatdhësuar nga luftërat e huaja.

Organizatave jo-qeveritare si ATRC, CDF, FIQ dhe CBM kanë përfituar nga mbështetja e GCERF, si rezultat i zbatimit të programeve që ofrojnë trajnime për aftësitë profesionale, trajnime të liderimit, aktivitete kulturore dhe sportive për individët dhe komunitetet e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm. Përmes këtyre iniciativave, GCERF synon të krijoj një ambient të sigurtë dhe të përshtatshëm për riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës.

Ngjajshëm, QKSS ka zbatuar programe për rehabilitimin dhe riintegrimin e qytetarëve të kthyer nga zonat e luftës, me fokus tek fëmijët e kthyer. Për më se gjashtë vjet, QKSS ka hulumtuar nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm, ndikimin e propagandës, si dhe sfidat për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës. QKSS, së bashku me partnerët e tjerë lokalë si QKRMT dhe Partnerët Kosova kanë zbatuar edhe projekte për të lehtësuar procesin e riintegrimin të të kthyerve nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Qeveria e Holandës mbetet ndër donatorët kryesor në Kosovë dhe rajon në çështjet e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit si dhe duke mbështetur përpjekjet e vendeve të rajonit për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës. Mbretëria e Holandës është ndër donatorët më të mëdhenj të fondacionit të GCERF. Për më tepër, ata kanë mbështetur organizatat si QKSS dhe CBM me projekte për R&R si dhe forcimin e reziliencës në nivel komuniteti ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ka qenë shumë aktive me projekte dhe mbështetje për MPB dhe Shërbimin Korrektues, me aktivitete për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës, me projekte konkrete për ide biznesi, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për të kthyerit.

Organizata Community Development Fund (CDF) me mbështetjen e GCERF ka zbatuar dy projekte në procesin e R&R për gratë dhe fëmijët e kthyer nga zonat e luftës. Përmes këtyre projekteve, CDF ka organizuar trajnime joformale të edukimit si dhe aktivitete rekreative për fëmijët e kthyer nga zonat e luftës. Këto kanë ndihmuar që fëmijët të mos vuajnë më nga stigma, diskriminimi e izolimi. Për më shumë, kjo organizatë është duke ndihmuar gratë e kthyer nga zonat e luftës me trajnime profesionale e me ide



biznesi. Këto projekte po bëhen në bashkëpunim të ngushtë me MPB-në e ShSK-në, pasi gratë përfituese janë nën mbikëqyrjen e ShSK-së. Ka edhe nisma të tjera në proces të implementimit, të cilat synojnë të mbështesin përpjekjet e institucioneve qendrore në R&R.

ATRC është duke zbatuar programin e ri për R&R në Kosovë të mbështetur nga GCERF. Ky program synon krijimin e një ambienti të sigurtë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës duke punuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve shtetërore për R&R. Kjo organizatë do të organzoj trajnime të specializuara për ShSK dhe institucionet e tjera për R&R.

GCERF ka mbështetur edhe organizatën Community Building Mitrovica (CBM) me aktivitete për R&R e të kthyerve nga zonat e luftës për rajonin e Mitrovicës. Si pjesë e këtij projekti parashihen të mbështeten fëmijet e kthyer me aktivitete edukative. Edhe të kthyerit do të mbështeten me trajnime profesionale dhe ide biznesi.

Pothuajse në asnjë program R&R, të zbatuar në Kosovë, nuk ka qenë i përfshirë Shërbimi Sprovues i Kosovës, përkundër faktit se ky institucion ka një rol shumë të rëndësishëm në trajtimin e individëve të akuzuar për vepër terrorizmi, që janë dënuar ose janë liruar me kusht.



SFIDAT DHE NEVOJAT NË PROCESIN E REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT (R&R)

Procesi R&R ishte fenomen i ri për institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë në Kosovë, sidomos për SHSK. R&R dhe trajtimi i luftëtarëve të huaj të kthyer në vendet e tyre ka qenë sfidë edhe për vendet perëndimore, të cilat kanë institucione të specializuara të drejtësisë dhe sprovuese. Fillimisht në Kosovë i gjithë fokusi për ngritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm ishte tek Policia e Kosovës, MPB, si dhe ShKK. ShSK vazhdimisht është neglizhuar nga trajnimet, projektet e mbështetja prej donatorëve të huaj në çështjet e P-CVE dhe R&R. Nuk ka pasur ndonjë plan të qëndrueshëm nga ana e institucioneve se si pritet të trajtohen të kthyerit në Kosovë, e as për rolin ShSK-së në këtë drejtim.

MUNGESA E NJOHURIVE BAZË TË STAFIT TË SHSK-SË

Rehabilitimi dhe Riintegrimi, si dhe trajtimi i rasteve që janë të dënuar për vepra terrorizmi dhe ekstremizmi të dhunshëm, mbeten sfidë për ShSK-në. Ky institucion përballet me mungesë të informacioneve bazë rreth shkaktarëve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, identifikimit të shenjave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Për më shumë, ky institucion përballet edhe me mungesë të përvojës se cila është qasja e duhur për t'i trajtuar rastet e të dënuarve për terrorizëm. ShSK, rastet e dënuara për terrorizëm i trajton me të njëjtat procedura sikurse të dënuarit për vepra të tjera penale. Të dënuarit për terrorizëm duhet të kenë trajtim të veçantë për shkak të specifikave që ka ky fenomen, sidomos aspekti ideologjik e psikologjik i tij. Mungesa e njohurive për hartimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegritimit për të akuzuarit për terrorizëm limiton suksesin e ShSK për trajtimin e rasteve të akuzuara për terrorizëm, çka do ta bënte më të lehtë procesin e integritimit në komunitetin e të dënuarve për vepra terrorizmi.

Duke marrë parasysh sfidat me të cilat përballet ShSK, stafi i këtij institucioni ka nevojë për trajnime të specializuara rreth njohurive bazë të fenomenit të luftëtarëve të huaj, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Njohuritë e stafit të ShSK duhet të përfshijnë edhe termat bazë të terrorizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm, historikun dhe shkaktarët e përhapjes së terrorizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, si dhe rolin e familjes dhe të komunitetit në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.



NUMRI I LIMITUAR I STAFIT NË SHSK

Shërbimi Sprovues përballet me mungesë të stafit për kryerjen e punëve sipas mandatit ligjor. Kjo i limiton mundësitë që individët e dënuar për terrorizëm të trajtohen profesionalisht nga ana e ShSK-së, për shkak të mungesës së stafit të specializuar për këto raste. Aktualisht, në ShSK punojnë gjithsej 65 punonjes kurse, të aprovuar me buxhet janë 75 punonjes . Pra ende nuk është potësuar numri i punonjësve ashtu sic është paraparë me buxhet. Një pjesë e madhe e tyre, rreth 25, janë staf menaxhues e administrativ. Me trajtimin e të dënuarve apo të liruarve më kusht, duke përfshirë edhe ata për terrorizëm, merren rreth 40 zyrtarë.. Përgjatë viteve, numri i rasteve për trajtim në ShSK është rritur vazhdimisht, por kjo nuk është përcjellë edhe me rritjen e stafit për këtë institucion. Përkundër planeve të Qeverisë së Kosovës për shtimin e numrit të stafit për ShSK-në, ende nuk është bërë ndonjë veprim konkret. Për më shumë, edhe vetë procedurat e rekrutimit dhe të përgatitjes së stafit të ShSK për trajtimin e personave të akuzuar për vepra të ndryshme penale marrin kohë, dhe pikërisht për këtë rekrutimi i stafit shtesë për ShSK duhet të bëhet me urgjencë.

MUNGESA E NJËSISË PËR MENAXHIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Aktualisht ShSK trajton numër të madh të individëve të akuzuar për vepra të ndryshme penale të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Trajtimi i këtyre rasteve, ku bëjnë pjesë kryesisht personat e kthyer nga luftërat e huaja, kryhet nga zyrtarët e njëjtë që trajtojnë individët e dënuar për vepra të tjera penale. Asnjë zyrtar aktual i cili menaxhon me trajtimin e të dënuarve për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, nuk është i specializuar në fushën e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, apo të rehabilitimit dhe riintegritimit të të kthyerve nga zonat e luftës. Madje, edhe procedura dhe praktikat që zbatohen për të dënuarit me këto vepra janë të njëjta sikurse për të dënuarit për vepra të tjera penale. Për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, buxhetore, kapaciteteve profesionale, iniciativës së menaxhmentit të Ministrisë së Drejtësisë dhe ShSK-së, si dhe përkrahjes së limituar të donatorëve, ShSK nuk ka arritur të krijojë kuadro të specializuara apo njësinë e specializuar për menaxhimin e rasteve për personat e akuzuar për vepra penale të terrorizmit. Kuadrot e specializuara apo Njësia për Menaxhimin e Terrorizmit do të duhej të përbëhej nga ekspertë të terrorizmit, juristë, punonjës socialë, psikologë, sociologë, teologë e zyrtarë të tjerë, të specializuar në temat që lidhen me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe R&R. Kjo njësi do ta ndihmonte ShSK-në dhe Ministrinë e Drejtësisë me trajtimin e suksesshëm të rasteve të terrorizmit. Njësia do të ndihmonte ShSK-në edhe me monitorimin e progresit dhe procesin e de-radikalizimit të individëve të dënuar për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, të cilët trajtohen nga ShSK.

Një njësi e tillë është themeluar në ShKK e cila ka ndihmuar për trajtimin e suksesshëm të rasteve të terrorizmit në ShKK dhe hartimin e procedurave të veçanta për menaxhimin e atyre rasteve. Ministria e Drejtësisë dhe Menaxhmenti i ShSK duhet të sigurojnë fonde dhe mbështetje qoftë nga buxheti i shtetit ose nga donatorët ndërkombëtarë,



për ta themeluar Qendrën për Menaxhimin e Terrorizmit, duke u bazuar në praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian e duke iu përshtatur rrethanave të vendit.

KOORDINIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE NË ÇËSHTJET E REHABILITIMIT

Koordinimi ndërmjet institucioneve dhe agjencive bartëse të procesit R&R për të kthyerit nga luftërat e huaja mbetet sfidues. Institucionet e shtetit përballen me probleme për ndarjen e informacioneve, përgatitjen e trajnimeve të përbashkëta, ndarjen e raporteve analitike dhe monitoruese për individët e dënuar për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin ose hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të R&R për qytetarët e kthyer nga luftërat e huaja. Prej vitit 2014, institucionet e vendit kanë zbatuar programe R&R për individët e dënuar për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Këto projekte kanë qenë ad hoc, jo të planifikuara mirë, afatshkurtra dhe në to nuk janë përfshirë institucionet relevante si ShSK.

ShSK ka nevojë për më shumë bashkëpunim dhe ndarje të informatave nga ana e ShKK, MPB dhe Policisë së Kosovës për individët e dënuar me kusht për vepra penale të terrorizmit. Gjatë procedurave dhe procesit të lirimit me kusht duhet të ketë më shumë transparencë dhe të informohen të paktën 2 muaj më herët institucionet si ShSK.ShKK dhe institucionet e tjera në prag të lirimit me kusht për individë të caktuar duhet t'i ndajnë raportet e vlerësimit, të sjelljes, dhe të dhënat e tjera me ShSK-në, për t'u përgatitur që ta trajtojnë sa më mirë e profesionalisht rastin.

Ka nevojë për një bashkëpunim shumë më të ngushtë kur bëhet fjalë për lirimin e një ish-luftëtari të huaj ose të dënuari për terrorizëm në komunitet. Sigurisht, një komunitet më i informuar – përfshirë ata që do të angazhohen drejtpërdrejt me të kthyerit – do të lehtësojë procesin e riintegrit të të dënuarve për terrorizëm në komunitet.


MUNGESA E BUXHETIT TË VEÇANTË PËR R&R

Të gjitha aktivitetet dhe projektet R&R që janë zbatuar në Kosovë deri më tani, duke përfshirë edhe ato të shërbimit sprovues e korrektues, kanë qenë të mbështetura nga organizatat dhe donatorët ndërkombëtarë. Pra, në mungesë të buxhetit, institucionet e vendit janë të limituara në hartimin e planeve për zbatimin e aktiviteteve R&R, si dhe shpesh varen nga prioritetet e donatorëve në çështjet e R&R. Edhe ShSK përballlet me të njëjtin problem. Mungesa e buxhetit të dedikuar për R&R e limiton këtë institucion në zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe të riintegrit për personat e dënuar për vepra terrorizmi. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të gjejnë forma për të hartuar një buxhet të veçantë për R&R që ua mundëson agjencive të tyre zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të R&R, pa u varur vetëm tek ndihma dhe përkrahja e donatorëve të huaj apo mbështetja e organizatave të shoqërisë civile.



PËRZIERJA E ROLEVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË INSTITUCIONEVE R&R

Viteve të fundit parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm ishte ndër temat që pati vëmendje të madhe të bashkësisë ndërkombëtare dhe të institucioneve vendore. Shumë organizata ndërkombëtare filluan të zbatojnë projekte të shumta në fushën e ekstremizmit të dhunshëm dhe R&R në Kosovë. Në të shumtën e rasteve u përziën roli dhe mandati i institucioneve të ndryshme në luftimin e ekstremizmit ose në zbatimin e aktiviteteve R&R. Mungesa e njohurive midis institucioneve për rolet dhe përgjegjësitë e tyre specifike në procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit ende mbetet problematike, sidomos ndërmjet nivelit lokal dhe qendror. Edhe pse legjislacioni në fuqi e njeh ShSK-në si organ përgjegjës për t'u kujdesur për trajtimin dhe mbikëqyrjen e individëve të dënuar ose liruar me kusht për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë edhe veprat e terrorizmit, në praktikë është ndryshe. ShSK është shumë pak i përfshirë në procesin e zbatimit të aktiviteteve R&R ku përfitues janë gratë e dënuara me kusht për vepra terrorizmi apo ish-luftëtarët e huaj të liruar me kusht. Ministria e Punëve të Brendshme mbetet adresa e vetme për koordinimin dhe zbatimin e programeve R&R për individët e dënuar për vepra terrorizmi, duke përfshirë edhe ata që janë të dënuar me kusht. Kjo ndodh për faktin se MPB ka qenë e suksesshme në zbatimin e aktiviteteve të shumta me të kthyerit, dhe ka ndërtuar një besim me të kthyerit dhe familjet e tyre.



REKOMANDIMET

TRAJNIME TË TË SPECIALIZUARA PËR R&R

Shërbimi Sprovues i Kosovës duhet të organizojë trajnime të specializuara për stafin e vet me qëllim të forcimit të kapaciteteve të tyre profesionale, të rritjes së njohurive rreth parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe zbatimit të programeve të R&R. Stafi i ShSK ka nevojë për trajnime më të avancuara mbi konceptet e R&R, ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, praktikave të R&R dhe aftësive të larta drejtuese për qendrat e ShSK. Trajnimet duhet të fokusohen edhe në identifikimin e hershëm të shenjave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizimit në Kosovë, si dhe monitorimin e progresit dhe sjelljeve të individëve të dënuar për vepra terrorizmi.

THEMELIMI I NJËSISË PËR MENAXHIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE REHABILITIMIN

Rastet e individëve të dënuar për terrorizëm të mbikëqyrur nga ShSK trajtohen me të njëjtat procedura sikur ato të individëve të dënuar për vepra të tjera penale. Përkundër mungesave të mëdha të stafit brenda ShSK-së, ky institucion duhet të fillojë procedurat për themelimin e njësisë së veçantë për menaxhimin e rasteve të terrorizmit apo formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo njësi duhet të jetë e përbërë nga juristë, psikologë, sociologë, punonjës socialë e individë të profileve të ndryshme, të trajnuar me çështjet e terrorizmit dhe R&R. Kjo njësi do të ndihmonte ShSK-në në procesin e rehabilitimit dhe riintegritit për individët e dënuar për vepra terrorizmi, si dhe trajtimin sa më profesional të rasteve të terrorizmit që janë nën mbikëqyrjen e ShSK-së.

RRITJA E NUMRIT TË STAFIT TË SHSK-SË

Shërbimi Sprovues i Kosovës përballet me mungesë të stafit operacional për trajtimin e rasteve që trajtohen nga ata. Ministria e Drejtësisë duhet urgjentisht të fillojë procedurat për rekrutimin e stafit shtesë të ShSK-së në përputhje me nevojat e këtij institucioni. Stafi shtesë duhet të trajnohet dhe të specializohet duke u bazuar në nevojat e ShSK-së, si dhe të trajnohet për të trajtuar rastet specifike të veprave penale. Ky veprim do të ndihmonte ShSK që të krijonte kuadro apo njësi të veçanta të specializuara për trajtimin e rasteve të veprave specifike penale që kërkojnë qasje me të veçantë, siç është rasti i të dënuarve për terrorizëm.



ALOKIMI I BUXHETIT TË VEÇANTË PËR R&R

Mungesa e fondeve ose një buxhet i dedikuar që do të mundësonte financimin e programeve të R&R dhe qëndrueshmërinë e tyre është një tjetër sfidë e theksuar nga të intervistuarit dhe të gjeturat e këtij vlerësimi për ShSK. Shumica e aktiviteteve dhe projekteve të kaluara dhe aktuale të R&R, përfshirë ato që janë të drejtuara nga shteti, varen nga ndihma e donatorëve të huaj ose nga organizatat lokale të shoqërisë civile. Ka pasur shumë pak iniciativa vendore për zbatimin e programeve R&R nëpërmjet Shërbimit Sprovues. ShSK nuk ka ndonjë buxhet të veçantë për të zbatuar aktivitete R&R në të cilat do të përfshiheshin individë të akuzuar për vepra terrorizmi. Mungesa e fondeve të veçanta i kufizon edhe iniciativat e ShSK-së për të zbatuar programe për R&R apo për ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. Ministria e Drejtësisë duhet të alokojë një buxhet të veçantë për ShSK dhe ShKK, që do të ndihmonte menaxhimin sa më të mirë të rasteve të trajtuara nga ShSK.

PËRMIRËSIMI I KOORDINIMIT INSTITUCIONAL NË R&R

Shërbimi Sprovues, Shërbimi Korrektues dhe Policia e Kosovës po përballen me sfida të mëdha në procesin e bashkërendimit, sidomos në çështjet e PCVE dhe R&R për individët e dënuar për terrorizëm. Shërbimi Sprovues dhe Korrektues i Kosovës dhe Policia e Kosovës duhet të bashkërendojnë më mirë aktivitetet e tyre në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit, duke ndarë të dhënat dhe informatat e nevojshme ndërmjet vete, duke rritur besimin ndërmjet tyre, si dhe duke përgatitur trajnime e programe të përbashkëta të rehabilitimit dhe riintegrit për individët e dënuar për vepra terrorizmi.

BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

ShSK duhet të ndërtojë një bashkëpunim të mirë me komunitetin apo familjarët e të dënuarve për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin që i ka nën mbikëqyrje. Në të kaluarën është vërejtur mungesë besimi ndërmjet individëve të dënuar për vepra terrorizmi si dhe institucioneve të drejtësisë. ShSK duhet të ndërtojë komunikim të rregullt me familjarët dhe rrethin ku jetojnë të dënuarit për vepra terrorizmi që janë nën mbikëqyrje të ShSK-së. Komunikimi i rregullt do të rrisë besimin e komunitetit të ShSK-së dhe do të lehtësojë procesin e rehabilitimit dhe të riintegrit në komunitet për të kthyerit nga luftërat e huaja. Kjo të krijonte mundësi për të përcjellë procesin e deradikalizimit për të dënuarit për vepra terrorizmi dhe ekstremizmi të dhunshëm. Kjo do të mund të bëhej nëpërmjet një bashkëpunimi sa më të mirë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, që ka ndërtuar një nivel të lartë besimi të të kthyerit nga luftërat e huaja dhe familjet e tyre.



OFRIMI I NJË KËSHILLTARI PËR R&R PËR NEVOJAT E SHËRBIMIT SPROVUES

ShSK ka nevojë për një ekspert të fushës së R&R apo terrorizmit për ngritjen e kapaciteteve profesionale në çështjet e trajtimit të të dënuarve për terrorizëm. Për më shumë, ky profesionist do të ndihmonte ShSK-në me hartimin e procedurave të veçanta për trajtimin e rasteve të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ministria e Drejtësisë ose donatorët e huaj duhet të identifikojnë mënyra ose forma për angazhimin e përkohshëm të një eksperti vendor ose të huaj që do të ndihmonte ShSK-në në zbatimin e aktiviteteve R&R, si dhe trajtimin sa më të mirë të individëve të akuzuar për vepra terrorizmi që janë nën mbikëqyrjen e ShSK.

